

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Efiçenca Mjedisore në Qytet Studenti”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Qese mbledhëse - 33141610-9; Kosha Mbeturinash - 39224340-3; Panele - 44175000-7

Vlera e Fondit Limit: **9,083,333 (nëntë milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre)** lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 Referuar pikës 1 të shtojcës 7, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e

përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 10 të DST-së.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar..*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: "Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: "40% të vlerës së parashikuar të kontratës ne procedurat e prokurimit....." si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare", si dhe në legjisllacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit vendor (Komuna/Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore (për NIPT-in kryesor dhe NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar); në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të Operatorëve Ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-së.

****Kriteri 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Këto dokumenta duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar.*

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20%

të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”(i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a) Standardin ISO 9001:2015 ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Standardin ISO 14001:2015 ose ekuivalent (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të mjedisit, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme), dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).
- c) Standardin ISO 45001:2018 ose ekuivalent (e përditësuar) për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme), dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma

ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

d) Standartin ISO 50001:2018 ose ekuivalent (e përditësuar) për menaxhimin e energjisë që ofron kuadrin më të fortë për optimizimin e efikasitetit të energjisë, objekt i së cilës të jetë ne përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme), dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatat ISO sipas zerave të mallrave apo shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar,

... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...” si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

ISO 14001:2015 (ose e përditësuar) specifikon kërkesat e përgjithshme për vendosjen e një sistemi të menaxhimit mjedisor në një kompani. Ai përqendrohet në njohjen e të gjitha aspekteve mjedisore dhe menaxhimin efektiv të pasojave të aktivitetit të një kompanie duke e mundur atë për të përmirësuar ndikimin e performancës së përgjithshme mjedisore të kompanisë. Një organizatë mund të marrë dhe zbatojë certifikimin ISO 14001, pavarësisht nga madhësia ose qëllimi i saj. Sistemet e menaxhimit të mjedisit bazuar në ISO 14001 ofrojnë mundësinë për të identifikuar, vlerësuar dhe menaxhuar aspektet mjedisore të një organizate me qëllim :

- Parandalimit të dëmtimit të mjedisit;
- Vlerësimit të aspekteve mjedisore;

- Përmirësimin e performancës mjedisore;
- Respektimin e ligjeve;
- Ruajtjen e burimeve natyrore dhe uljen e kostos;
- Përmirësimin e imazhit të kompanisë;
- Përmirësimin e komunikimit me figurat e autoritetit.

ISO 45001:2018 (ose e përditësuar) është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001:2018 (ose e përditësuar) është një standard i ri ndërkombëtar i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar, të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizimeve dhe aktiviteteve objekt kontrate, duhet të disponojë punonjës të specializuar të profileve si më poshtë si më poshtë:

- ✓ **1 (një) Ekspertë Trajnues** (Ekspertë mjedisi / inxhinier mjedisi ose në fusha të tjera të ngjashme.)
- ✓ **1 (një) Inxhinier Elektrik** (Me kualifikim universitar arsim i lartë universitar dhe të paktën 1 vit përvojë pune në organizata të industrisë elektrike.)
- ✓ **1 (një) Specialist Elektriciçist** (Me kualifikim arsim i mesëm profesional dhe përvojë pune në organizata të industrisë elektrike.)
- ✓ **1 (një) Punëtor për transportim dhe montim të paneleve diellore** (Me kualifikim arsim i mesëm profesional,)
- ✓ **1 (një) Kordinator projekti për takimet në “Qytet Studenti”** (Me kualifikim universitar Master ose ekuivalent në studime energjetike, ose të ngjashme.)
- ✓ **1 (një) Menaxher i energjisë** (Me kualifikim universitar arsimin e lartë në inxhinieri mekanike, elektrike, fizike, elektronike, arkitekturë, urbanistikë, inxhinieri ndërtimi, inxhinieri mjedisi, shkencat e fizikës, mjedisit dhe kimisë industrial, inxhinieri ekonomike ose në fusha të tjera të ngjashme. Personi duhet të jetë i pajisur me certifikatën përkatëse të menaxherit të energjisë të lëshuar nga “Agjencia e Eficencës së Energjisë” dhe duhet të ketë eksperiencë pune në profil.)

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë vijon:

- Eksperienca e punës dhe profilet e specialistëve duhet të vërtetohen nga ana e operatorit ekonomik me kontratat individuale të punës (të vlefshme gjatë kohës së zhvillimit të projektit), kopje të librezave të punës, kopje të diplomave, jetëshkrimet (CV) si dhe çdo kualifikim tjetër profesional i sipërcituar.

Kriteri 2.3.3 dhe nënpikat e tij do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga ofertuesit i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar) dhe nenit 40, pika 5 b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Konkretisht:

Neni 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pika 4:

[...Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...] VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Neni 40, pika 5 b).

“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose..”

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa për staf është e nevojshme për të garantuar Autoritetin Kontraktor se OE disponon kapacitetet me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen.

Numri i përcaktuar për secilin specialist është përlllogaritur, duke marrë në konsideratë proceset, veprimtaritë apo shërbimet që përfshihen për realizimin e kontratës dhe është në përpjestim me natyrën, përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe limitet kohore të parashikuara për të përfunduar këtë kontratë.

- a) **1 (një) Ekspertë Trajnues** – Eksperti Trajnues duhet të jetë në profilin inxhinier mjedisi/ inxhinier kimist ose ne profile te tjera te ngashme. Roli i tij do të jetë i lidhur gjithashtu edhe me organizimin e konferencës përmbyllëse në Qytet Studenti, mbi realizimin e objektit të prokurimit. Për të duhet të paraqitet: Diplomë/ certifikatë kualifikimi me profesion/ kimist/ inxhinier mjedisi ose në profile të ngjashme. Kontratë pune përkatëse-librezë pune - duhet të ketë eksperiencë pune. Të paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore, individuale e lëshuar nga E-Albania. – Eksperti i mësipërm nëse është i punësuar njëkohësisht në sektorin privat apo publik, duhet të paraqesë deklaratën përkatëse.
- b) **1 (një) Inxhinier Elektrik** - Me kualifikim universitar arsim i lartë universitar në profilin inxhinier elektrik dhe të paktën 1 vit përvojë pune në organizata të industrisë elektrike. Të jetë i punësuar me kontratë shërbimi/cdo marrëveshje tjetër kontraktuale. Inxhinieri elektrik do të trajtojë të gjitha aspektet e ndikimit të energjisë, njohjen e standardeve bazë elektrike për vendosjen e pajisjeve elektrike, metodat e kontrollit dhe matjes së tyre; aftësia për të përdorur instrumente, pajisje dhe vegla të përdorura për të matur dhe testuar pajisjet elektrike; aftësia për të kryer teste parandaluese,

matje dhe rregullim të pajisjeve elektrike; aftësia për të kryer riparime të vogla të instrumenteve dhe pajisjeve të automatizimit të përdorura në matjen dhe testimin e pajisjeve elektrike; leximi i qarqeve elektrike. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.

- c) **1 (një) Specialist Elektriçist** – Specialisti elektriçist duhet të ketë përvojë pune profesionale në organizata të industrisë elektrike. Në funksion të rolit të tij është e rëndësishme që specialisti duhet të kryejë/asistojë çdo proces të planifikuar që të çojë në minimizimin e konsumit të energjisë elektrike. Të jetë i punësuar/me kontratë shërbimi/çdo marrëveshje tjetër kontraktuale.
- d) **1 (një) Punëtor për transportim dhe montim të paneleve diellore** - Punëtori në këtë profil është konsideruar si element i rëndësishëm i kontraktorit për transportimin dhe montimin e paneleve diellore. Siguria e produktit, informacioni mbi përdorimin me efikasitet të tij dhe asistencë e punonjësit gjatë marrjes së paneleve dhe realizimi i montimit të tyre do të na çojë në një menaxhim të mirë të kësaj procedure. Për instalimin e paneleve diellore i kontraktuari duhet të marrë masa që përveç pajisjeve të parashikuara duhet të asistojë me çdo element tjetër (pajisje/ vegla pune) të nevojshme për kryerjen e projektit dhe implementimin e pajisjeve.
- e) **1 (një) Kordinator projekti për takimet në “Qytet Studenti”** – Koordinator i projektit do të jetë personi që do të menaxhojë dhe koordinojë të gjitha aktivitetet e planifikuara për t’u zhvilluar gjatë kohëzgjatjes së kontratës. Do të angazhohet në koordinimin e trajnimeve, konferencave dhe takimeve të cilat do të zhvillohen me studentët për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e ndarjes në burim të mbetjeve si proces; organizimin e pyetësorëve apo marrjen e informacioneve mbi mundësitë e reja për përmirësime dhe investime në këtë fushë.
- f) **1 (një) Menaxher i energjisë** - Duke qenë se ky projekt konsiston në rritjen e efikasitetit mjedisore dhe energjitike gjatë periudhës së implementimit të tij duhet që, i kontraktuari të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) person të certifikuar si Menaxher Energjie, i cili do të bëjë monitorim të vazhdueshëm dhe do të përgatisë një raport në lidhje me konsumin aktual të godinës dhe parashikimin për ulje të konsumit. Personi i kontraktuar në këtë pozicion duhet të ketë arsimin e lartë në inxhinieri mekanike, elektrike, fizike, elektronike, arkitekturë, urbanistikë, inxhinieri ndërtimi, inxhinieri mjedisi, shkencat e fizikës, mjedisit dhe kimisë industrial, inxhinieri ekonomike ose në fusha të tjera të ngjashme. Personi duhet të jetë i pajsur me certifikatën përkatëse të menaxherit të energjisë të lëshuar nga “Agjencia e Efikasitetit të Energjisë” dhe duhet të ketë eksperiencë pune në profil.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike (termave të referencës):

Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit nr. 729, për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Argumentimi, sipas materialit të përgatitur nga struktura e posaçme:

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja “d”, dhe nenit 64, shkronja “a” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin” (i ndryshuar); nenit 36 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); nenit 76 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar); VKB-së nr. 125 datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2024” (i ndryshuar) ; grupi i punës i ngritur me Urdhër Titullari nr.1268, datë 24.04.2024 për “Ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit, konform legjislacionit në fuqi për realizimin e procedurës me objekt: ”Hartimi i Planit të Veprimit për Ndryshimet Klimatike”, kanë hartuar kërkesat për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm duke përcaktuar qartë kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Bazuar në termat e referencës të miratuara dhe hartuara nga struktura e ngarkuar për këtë qëllim, Grupi i punës vendosi të bëjë studimin e tregut për përlllogaritjen e vlerës së kontratës, mbi bazën e të cilës përcaktohet fondi limit për procedurën e prokurimit. Pas identifikimit të subjekteve që operojnë në fushën e aktivitetit të objektit që prokurohet, kërkesa për përlllogaritjen e fondit limit me qëllim llogaritjen e vlerës së kontratës, ju dërgua 3 subjekteve, në përputhje me kërkesat teknike të përgatitura nga komisioni i ngritur me Urdhër të Titullarit të Bashkisë Tiranë “Për krijimin e komisionit për hartimin e termave të referencës dhe përcaktimin e fondit limit për procedurën **“Eficienca Mjedisore në Qytet Studenti”**”.

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM: Ky projekt ka si objektiv të përgjithshëm prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjise, e cila është energji e pastër që ndikon në uljen e emetimeve të CO², si dhe në rritjen e efikasitetit energjitike dhe mjedisore, si dhe zbatimin e metodave efikase për menaxhimin e mbetjeve ushqimore.

QËLLIMI: Qëllimi i vënies në zbatim të këtij projekti është shfrytëzimi i hapësirës së taracës së godines nr.11 për instalimin e paneleve fotovoltaike të cilat do të mundësojnë prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet rrezatimit diellor duke minimizuar kështu konsumin e energjisë elektrike të marrë nga rrjeti, si dhe duke rritur efikasitetin e godinës si nga ana energjitike ashtu dhe mjedisore. Gjithashtu në fokus të këtij projekti është edhe informimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve nëpërmjet promovimit të praktikave më pak të dëmshme për mjedisin, duke sjellë në këtë mënyrë një përballje më efikase në lidhje me sfidat mjedisore që ndeshemi shpesh në përditshmërinë tonë.

Një tjetër fokus i këtij projekti është edhe menaxhimi me efikasitetin e mbetjeve duke realizuar ndarjen e tyre që në burim.

Referuar vendit specifik ku do të implementohet ky projekt rezulton që kemi të përfshirë dy godina me nga 5 kate secila ku të dy godinat janë të lidhura me njëra-tjetrën me një seksion me një kat. Të dy godinat janë të organizuara në apartamente me dy dhoma, me një nyje hidrosanitare për të dy dhomat. Në çdo dhomë janë dy deri në tre studentë. Në çdo kat ka 49 studentë dhe në total për të dy godinat janë

450 studentë. Janë gjithsej 120 tualete në të dy godinat, ku në çdo kat ka 12 tualete në çdo godine. Në çdo tualet ka dalje dushi dhe lavaman. Ndërkohë që në çdo kat ka nga një ambient guzhine me dalje lavamani. Gjithsej në të dy godinat ka 10 kuzhina.

Në kuadër të këtij organizimi, një pjesë tjetër që do të ndërhyhet në secilin kat të çdo godine do të vendosen 4 kosha me tipologji me katër ngjyra të ndryshme (plastike /alumin/ letër/ mbetje organike) të cilët do të jenë me kapacitet prej 80 litra çdo kosh si dhe katër kosha do të vendosen jashtë çdo godine me një kapacitet prej 120 litra secili kosh. Ky organizim do të na sigurojë një efektivitet më të lartë lidhur me ndarjen e mbetjeve në bazë të kategorive. Referuar raportimeve, nga të dy këto godina kemi një akumulim prej 2.3 m³ mbetje në ditë.

Pra, në thelb fokusi i këtij projekti është ulja e konsumit të energjisë elektrike si dhe zbatimi i disa metodave më efektive për mirëmenaxhimin e mbetjeve, pra rritja e efijencës mjedisore dhe energjitike të godinave.

Termat e referencës me të gjithë elementët përbërës janë hartuar mbështetur në Ligjin Nr. 155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”, Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE:

1. Specifikimet teknike minimale të moduleve PV (fotovoltaik)

- Çdo modul duhet të jetë i pajisur me pllakën e emrit të prodhuesit, duke dhënë informacionin e mëposhtëm:
- Emri i prodhuesit
- Numri i modelit të modulit
- Numri i modulit serik
- Fuqia e vlerësuar
- Data e prodhimit
- Garancia për Performancë Lineare të Energjisë $\geq 85\%$ në 25 vjet
- Jetëgjatësia e garantuar e produktit ≥ 15 vjet
- Degradimi i produktivitetit në vitin e parë $\leq 3\%$
- Efijenca e modulit PV $\geq 21.5\%$
- Testet standarde: IEC 61215, IEC 61730

Korniza e modulit duhet të jetë prej çeliku ose alumini të anodizuar me vrima kullimi. Modulet e përzgjedhura PV do të jenë të përshtatshme për kushtet e vendit dhe testimi i tyre duhet të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Panelet duhet të jenë prodhim europian dhe të testuara në përputhje me kërkesat thelbesore të direktivave të Bashkimit Evropian.

2. Specifikimet teknike minimale për inverterat

- Frekuenca nominale 50 Hz
- Gama e frekuencës së funksionimit: 50 deri në 60 Hz

- Faktori i fuqisë: 0.8 vonesë ~ 0.8 kryesor
- Tensioni DC i valëzuar: përmbajtja e valëzimit nuk duhet të jetë më shumë se 1%
- Eficienca: $\geq 98,8\%$
- Gama e temperaturës së ambientit të funksionimit: $-25^{\circ}\text{C} \div +60$ gradë Celsius
- Funksionimi plotësisht automatik duke përfshirë zgjimin, sinkronizimin (kyçjen e fazës) dhe mbylljen

Inverteri duhet të jetë i pajisur me mbrojtje nga:

- Mbitensioni: si në hyrje ashtu edhe në dalje
- Mbirryma: si në hyrje ashtu edhe në dalje
- Frekuenca e rrjetit
- Qarku i shkurtër
- Tensioni i rrufesë i shkaktuar në dalje për shkak të burimit të jashtëm
- Ishullor
- Mbrojtja nga depërtimi: IP 66. (Vlerësimet IP66 janë niveli më i lartë i mbrojtjes së papërshkueshme nga uji dhe pluhuri)

Inverterat duhet të kenë ekran LCD në panelin e përparmë për monitorimin e funksionimit
Inverterat duhet të jenë në gjendje të monitorohen dhe kontrollohen si në nivel lokal ashtu edhe në distancë.

3.Stuktura e montimit dhe aksesorët e montimit

Strukturat e montimit duhet të jenë alumini dhe/ose çelik inok. Duhet të përzgjidhet një strukturë montimi me cilësi të mirë për të siguruar:

- Stabiliteti për shkak të kushteve të ngarkesës;
- Qëndrueshmëri për shkak të agjentëve atmosferikë;

Struktura e montimit dhe aksesorët e montimit duhet të jenë të përshtatshëm për çati të sheshtë. Këndi i animit duhet të jetë i tillë që të sigurojë efikasitet më të mirë.

Materiali i bulonave, vidave, dadove dhe rondeleve duhet të jetë çelik inoks

4.Moduli i monitorimit

Moduli i monitorimit duhet të bëjë të mundur monitorimin në kohë reale të prodhimit, tensioneve, rrymave, temperaturës si dhe të ç' do alarmi të regjistruar nga inverterat. Duhet të bëjë komunikimin në distancë me ethernet dhe duhet të ketë port komunikimi USB. Shkalla e mbrojtjes duhet të jetë IP65. Logaritmi i enkriptimit duhet të jetë me mekanizem WPA/WPA2. Duhet të operojë në temperatura -30°C deri në $+65^{\circ}\text{C}$ dhe lartësi deri në 4000 metra.

5.Kuadër shpërndarje

Përmasat e kuadrit duhet të jenë në varësi të automatit që do të përdoret . Shkalla e mbrojtjes IP55. Kuadri duhet të jetë i tokëzuar.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “**Efiçenca Mjedisore në Qytet Studenti**”.

Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverballi:

Dokumentat e tenderit;

Termtat e Referencës.

NJËSIA E PROKURIMIT: